



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# Raporti përfundimtar

Shqyrtimi i Tetë i Tarifave të Energjisë Elektrike

SHTES (2014-2015)

Kalkulimet e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit Publik me Energji  
Elektrike (FPEE)

## DEKLARATË

Ky Raport Vlerësimi është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesuara. Ai nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si tillë.

**24 Qershor 2014**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta .....</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Të hyrat e lejuara maksimale të furnizuesit publik të energjisë elektrike (FPEE) .....</b>	<b>4</b>
3.1	S-faktori dhe norma e interesit për përshtatjet.....	4
3.2	Shkalla e aplikueshme e Inflacionit.....	5
3.3	Përshtatjet e FPEE-së .....	5
3.3.1	Përshtatjet e kostove të Marzhës me Pakicë .....	5
3.3.2	Përshtatjet për kostot e pakontrolluara (Sigurimet) .....	5
3.3.3	Përshtatjet për kostot e Administratës Qendrore.....	6
3.3.4	Taksa për licencë .....	6
3.3.5	Kostot e Lejuara me Pakicë (RETMt) .....	6
3.3.6	Kostot e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes .....	6
3.3.7	Zhvlerësimi i lejuar .....	6
3.4	Kostot e lejuara të kapitalit punues (WCLCt).....	7
3.5	Faktori i përshtatjes së të hyrave - KREV .....	7
<b>4</b>	<b>Përmbledhje .....</b>	<b>9</b>



## **1 Hyrje**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë aktualisht është në proces të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) dhe Përshtatjet e Rregullta për Vitin e Dytë Relevant të SHTE7 të Shqyrtimit Tarifor për Gjeneratorët e Rregulluar (KEK), Sistemin e Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Kjo është hera e parë që ZRRE-ja i nënshtrohet një procesi të Përshtatjes së Rregullt me Rregullat e reja për vendosjen e çmimeve, proces ky i cili mundëson kontrollin tarifor shumë vjeçar.

ZRRE ju ka dhënë mundësi të licencuarve që të japin komentet në propozimet e dhëna nga ZRRE-ja në këtë Raport Vlerësimi. Qëllimi i këtij Dokumenti është që t'u komunikojë palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me të hyrat maksimale të lejuara.

## **2 Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta**

Në vitin 2013, ZRRE-ja ka kryer Procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) gjatë të cilit ka caktuar Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për pesë Vitet Relevante të ardhshme për Gjeneratorët e rregulluar (KEK), Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS/OSSH). MAR për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) është caktuar për një vit gjatë procesit të Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse sipas Rregullës për Vendosjen e Çmimeve për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike.

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve e aprovuar nga ana e ZRRE-së thekson se me qëllim të kalkulimit të ndryshimeve të lejueshme në MAR brenda secilit Vit Relevant duhet të kryhet procesi i Përshtatjeve të Rregullta. Kjo përfshinë përditësimin e humbjeve të lejuara për parashikimin e rrjedhjeve aktuale të energjisë, indeksin për kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Lejimet e Zhvlerësimit dhe Kthimin e Lejuar në raport me inflacionin, duke aplikuar faktorët e paracaktuar të efikasitetit dhe bërë përshtatjet për kostot e bartura për këta të licencuar. Procesit i Përshtatjeve të Rregullta ndryshon nga Shqyrtimi Periodik i tërësishëm gjatë të cilit ZRRE-ja shkon nëpër një shqyrtim të detajuar të Kostove të Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, humbjeve të lejuara dhe të faktorëve të efikasitetit dhe Programeve të Lejuara për Shpenzimet Kapitale. Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja vetëm në mënyrë mekanike bënë përshtatjen e ndryshimeve mes vlerave të lejuara dhe atyre aktuale nga që tanimë janë lejuar gjatë Shqyrtimeve Periodike.

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për FPEE janë caktuar për një periudhë një vjeçare por Vlerat Hyrëse të cilat janë përdorur për llogaritjen e MAR-it të FPEE janë caktuar gjatë Shqyrtimeve të Vlerave Hyrëse dhe janë të vendosura për një periudhë pesë vjeçare. MAR-i FPEE-së rivendoset gjatë çdo Përditësimi Vjetor për të korrigjuar ndryshimet mes kostove të parashikuara dhe atyre aktuale nën apo mbi kthimin e MAR-it gjatë Vitit Relevant për shkak të ndryshimeve mes faturimit të parashikuar dhe aktual dhe nën apo mbi kthimin e MAR-it për shkak të ndryshimeve mes kostove të parashikuara të shitjeve me shumicë të energjisë dhe atyre aktuale, dhe kostove të parashikuara dhe atyre aktuale që barten, në varësi të ndonjë ndarje të disbalancës në kosto dhe të ardhurat nga eksporti në mes të FPEE dhe Konsumatorëve të rregulluar .



Gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik, ZRRE-ja ka përcaktuar nivelin e lejuar të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet kapitale të lejuara, faktorët e efikasitetit, jetëgjatësinë Ekonomike të Aseteve, faktorët e profilizimit<sup>1</sup> dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit dhe S-faktorin për gjeneratorë e rregulluar, KOSTT dhe OSSH. Prandaj, niveli i përgjithshëm i këtyre lejimeve nuk është temë për diskutime gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta. Sa i përket parimeve të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve, gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja do të:

1. Caktoj indeksin për Kostot e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes për të gjithë operatorët e licencuar për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve për Konsumatorë (IHÇK) për të gjithë artikujt në Eurozonë;
2. Caktoj caqet e Disponueshmërisë për Gjeneratorët e Rregulluar;
3. Caktoj Ngarkesat e Energjisë dhe Ngarkesat e Kapacitetit për Gjeneratorët e rregulluar;
4. Përditësoj Kostot e Lejuara për Furnizim me Thëngjill (LGSCt) për Gjeneratorët e Rregulluar. Ky përditësim përfshinë kostot e paracaktuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimin dhe Kthimin e Lejuar për Mihjet duke përcjellë parimet e njëjta sikur për Gjeneratorët e Rregulluar. Kostot e paracaktuara për LGSCt përfshijnë ndryshimin mes kostove aktuale dhe të lejuara për furnizim me thëngjill gjatë Vitit paraprak Relevant të Periudhës Rregullative;
5. Përditësoj Kostot për Lëndët Tjera Djegëse (OTFCt) për Gjeneratorët e Rregulluar duke përfshirë ndryshimin mes kostove të lejuara dhe aktuale gjatë Vitit Relevant të parë të Periudhës Rregullative;
6. Llogaris Kostot e Shitjeve me Shumicë të Energjisë të cilat përfshijnë koston e energjisë së blerë nga Gjeneratorët e Rregulluar, nga Importet dhe Margjina e Shitjeve me Pakicë. Këto përditësime kanë për qëllim reflektimin e ndryshimeve mes kostove të lejuara dhe aktuale të blerjes së energjisë në Periudhën Paraprake Rregullative;
7. Caktoj Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSCt) për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimin mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale për Periudhën paraprake Rregullative të cilat mund të jenë rritur për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit;
8. Përditësoj MAR-in për OST-në për të reflektuar të hyrat e gjeneruara përmes Mekanizmit për Kompensime Ndërmjet OST-ve;
9. Përditësoj MAR-in për OST për të reflektuar ndryshimet mes Të Hyrave të Lejuara dhe të Hyrave Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
10. Llogarisë mbingarkesën për Energjinë e Ripërtërishme që do të shfrytëzohet për financimin e Fondit për Energji të Ripërtërishme (FER) me qëllim të pagesës së Tarifave Nxitëse (Feed-in Tariffs) për Gjeneratorët e BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE);

---

<sup>1</sup> ZRRE-ja nuk ka caktuar ndonjë Faktor të Profilizimit, mirëpo ata mund të caktohen vetëm gjatë Shqyrtimeve Periodike.



11. Caktoj Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Sistemit;
12. Caktoj Kostot e Lejuara nga Humbjet (LSSCt) për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimet mes kostove të lejuara dhe aktuale nga humbjet për Periudhën paraprake Rregullative që mund të dalin për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e Shpërndarjes.
13. Përditësoj MAR-in e OSSH-së për të reflektuar ndryshimin në mes Të Hyrave të Lejuara dhe Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
14. Caktoj Ngarkesat për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;
15. Llogaris Kostot e Lejuara të Shitjeve me Pakicë për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike që përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes së aktivitetëve të FPEE, kostot e korporatës, lejimet e zhvlerësimit dhe kostot tjera të arsyeshme të FPEE;
16. Caktoj MAR-in e ri të FPEE duke përfshirë ndryshimin mes faturimit të lejuar dhe aktual gjatë Periudhës paraprake Rregullative;
17. Caktoj Tarifa të reja për Shitjet me Pakicë për konsumatorët e rregulluar tarifor;

### 3 Të hyrat e lejuara maksimale të furnizuesit publik të energjisë elektrike (FPEE)

Ndryshe nga Gjeneratorët e Rregulluar, OST/OT dhe OSSH, MAR-i i të cilave është caktuar për periudhën 5 vjeçare, MAR-i i FPEE caktohet në baza vjetore. MAR-i i FPEE caktohet duke përdorur Vlerat Hyrëse që caktohen gjatë Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse (Shqyrtimi i fundit i Vlerave Hyrëse ishte harmonizuar me procesin e Shqyrtimit Periodik gjatë Shqyrtimit të 7 Tarifor të Energjisë Elektrike (SHTE7).

Sipas Rregullës për Çmimet e FPEE-së, procesi i caktimit të MAR-it për FPEE-n ndahet në tri faza:

- **Faza I:** Përcaktimi i kostos së importit. Gjatë kësaj faze FPEE do të dorëzojë ZRRE-së, së paku 80 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant, propozimin për kostot e importit për mbulimin e kërkesës.
- **Faza II:** Përcaktimi i kostos nga shitjet me pakicë: Gjatë kësaj faze FPEE-ja i dorëzon ZRRE-së propozimet e veta për Kostot e Shitjeve me Pakicë që duhet të mbulohen brenda vitit vijues. Kjo përfshinë kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes, kostot e lejuara të korporatës, zhvlerësimin e lejuar dhe çfarëdo kosto tjetër që më arsye kanë rrjedhur nga ana e FPEE-së gjatë ofrimit të shërbimeve të shitjeve me pakicë për Konsumatorët e Rregulluar;
- **Faza III:** Përcaktimi i Te Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifat e Rregulluara. Gjatë kësaj faze Furnizuesi Publik i dorëzon ZRRE-së propozimet e veta për MAR-in e FPEE-së për Vitin Relevant vijues.

#### 3.1 S-faktori dhe norma e interesit për përshtatjet

Sipas Shtojcës 1, nenit 2.1 të Rregullës për Çmimet e FPEE-së, norma e interesit që aplikohet për MAR-in e FPEE në çdo vit relevant llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e



përcaktuar nga ZRRE gjatë Azhurnimeve Vjetore të cilat reflektojnë preminë e pagueshme nga ana e operatorit të licencuar për huat afatshkurtra. Kjo ndryshon nga parimi i aplikuar në Rregullat tjera për Vënien e Çmimit<sup>2</sup> ku vlera e S caktohet gjatë Shqyrtimeve Periodike dhe mbahet konstante gjatë gjithë Periudhës Rregullatore.

ZRRE ka rivendosur vlerën e S e aplikueshme për përshtatjet e Furnizuesit Publik me Energji Elektrike si në vijim:

Norma e Kreditimit të Kosovës e marrë nga Buletini Mujor për Statistika i Bankës qendrore të Kosovës, tabela 14.2 (ODC Normat Efektive të Kamatave – normat kreditore të interesit<sup>3</sup>. Vlera e marrë paraqet normën kreditore për investimet afariste për kreditë deri në 1 vit. Kjo vlerë, për janar 2014 është 13.08%.

Norma finale e kamatës për përshtatjet paraqet vlerën për janar (13.08%) duke zbritur EURIBOR-in për janar (0.537 – 1-vit EURIBOR-i për janar 2014) + 0.598 (norma aktuale e EURIBOR) = 13.14%.

### **3.2 Shkalla e aplikueshme e Inflacionit**

FPEE- ja ka propozuar që shkalla e inflacionit që duhet aplikuar për përshtatjet e FPEE për vitin 2013 të jetë 2.5% meqë ata konsiderojnë se kjo paraqet “njësinë e duhur matëse për Kosovën”. Shkalla e inflacionit e propozuar nga ata rrjedh nga Raporti Vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2012.

ZRRE-ja ka vërejtur se propozimi i FPEE-s nuk është në linjë me parimet e Rregullës së Çmimit për FPEE. ZRRE-ja, për llogaritjen e shkallës së aplikueshme vjetore të inflacionit për FPEE-n, ka përdorur Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve për Konsumatorë (HICP) për të gjithë artikujt sikur se në Eurozonë. Shkalla e inflacionit që rezultoi është 0.7%.

### **3.3 Përshtatjet e FPEE-së**

#### **3.3.1 Përshtatjet e kostove të Marzhës me Pakicë**

ZRRE-ja ka përfshirë përshtatjen e ndryshimit gjatë llogaritjes së Marzhës me Pakicë për vitin 2013 sipas Raportit Sqarues. Ndryshimi prej €0.6 milion është përfshirë në MAR-in e FPEE.

#### **3.3.2 Përshtatjet për kostot e pakontrolluara (Sigurimet)**

KEDS-i ka kërkuar lejimet prej €0.16 milion për të mbuluar kostot për sigurimin shëndetësor të punëtorëve të tij me një kosto mujore prej €13.92 për një punëtor. KEDS pohon se kontrata është nënshkruar para marrjes përsipër të KEDS-it nga ana e investitorit privat (Kosovo Calik – Limak Energy).

---

<sup>2</sup> Respektivisht Rregulla për Vendosjen Çmimeve për Gjenerim, Transmision dhe Shpërndarje

<sup>3</sup> <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2014/MSB%20no.%20149.%20english.pdf>



### **3.3.3 Përshtatjet për kostot e Administratës Qendrore**

KEDS-i ka kërkuar t'i lejohen kosto prej €1.28 milion për mbulimin e shpenzimeve që dalin nga riallokimi i punëtorëve të Administratës Qendrore pas ndarjes së aktiviteteve mes KEDS dhe KEK. KEDS thekson se këto lejime do të përdoren për të mbuluar kostot shtesë për punonjësit e ri të cilët janë punësuar për të mbuluar pozitat që ishin paraparë në skemën organizative.

ZRRE-ja pret që ndarja e shërbimeve të përbashkëta do të rezultonte në një rritje të caktuar të kostove për ofrimin e shërbimeve të tilla.

ZRRE ka bërë përshtatjet e këtyre kostove gjatë përcaktimit të vlerave hyrse të MAR-it të FPEE.

### **3.3.4 Taksa për licencë**

KEDS-i ka kërkuar përshtatje për €0.098 milion për të mbuluar koston e taksës për licencë e cila ka rezultuar nga zbatimi i pagesave për licencë nga 1 maji 2013. ZRRE-ja ka marrë në konsideratë që KEDS-i t'i mbulojë këto taksa të licencës.

### **3.3.5 Kostot e Lejuara me Pakicë (RETMT)**

Kostot e lejuar me Pakicë për Furnizuesin Publik janë caktuar sipas nenit 10 të Rregullës së Çmimit për FPEE-në dhe përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e korporatës, kostot e zhvlerësimit dhe kostot tjera të arsyeshme që rrjedhin gjatë ofrimit të shërbimeve me pakicë për konsumatorët e rregulluar.

Edhe pse Kostot me Pakicë caktohen gjatë secilit Përditësim Vjetor, gjatë Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse, ZRRE-ja ka bërë një shqyrtim gjithëpërfshirës të Kostove me Pakicë të FPEE-së përgjatë 5 viteve relevante vijuese duke shfrytëzuar ekspertizën e saj si dhe ekspertizën këshilltarëve të saj. Gjatë secilit Shqyrtim Vjetor, ZRRE-ja do të caktojë lejimet për Operime & Mirëmbajtje dhe ato për Zhvlerësim duke u bazuar në rezultatet e shqyrtimit të ZRRE-së nga Shqyrtimi i Vlerave Hyrëse.

### **3.3.6 Kostot e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes**

Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes për vitin e dytë relevant janë vlerësuar të jenë €12.4 milion. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes për FPEE do të jenë përshtatur për inflacionin vjetor prej 0.7% për vlerën e lejuar më herët të OPMCT. Prandaj kostot përfundimtare O&M të lejuara për FPEE janë €12.4 milion.

### **3.3.7 Zhvlerësimi i lejuar**

Lejimet e zhvlerësimit të caktuara për vitin e dytë relevant është bazuar në shqyrtimin e ZRRE-së të planit për shpenzime kapitale të FPEE-s përgjatë pesë viteve relevante në vijim. Zhvlerësimi i lejuar për vitin e dytë relevant është llogaritur të jetë €0.2 milion. Zhvlerësimi i lejuar për FPEE-në përfshinë shkallën e lejuar vjetore të inflacionit prej 0.7% për zhvlerësimin e lejuar më herët. Prandaj, vlera përfundimtare e zhvlerësimit të lejuar për FPEE është €0.2 milion.



### 3.4 Kostot e lejuara të kapitalit punues (WCLCt)

Neni 11 i Rregullës për Çmimet e FPEE-së parasheh se Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike duhet t'i lejohet mbulimi i kostove të kapitalit punues. Kostot e lejuara të kapitalit punues do të llogariten duke përdorur kostot e financimit të këtij kapitali punues (EURIBOR + S%) plus shuma e kostove të lejuara me pakicë, kostot e lejuara të shitjeve me shumicë të energjisë, kostot e lejuara të shitjes me shumicë të kapacitetit dhe kostot e bartura. Formula për llogaritjen e kostove të lejuara të kapitalit punues është dhënë në paragrafin 2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Çmimet e FPEE-së:

$$WCLC = (1 / 12) * I_t * (RETR_t + WHPC_t + PSTC_t - NTFR_t)$$

*Ku:*

$I_t$  paraqet normën e interesit në vitin relevant  $t$ , që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga rregullatori gjatë azhurnimeve vjetore dhe që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurtëra s

$RETR_t$  Kostot e lejuara me pakicë në vitin relevant  $t$

$WHPC_t$  Kostot e energjisë së përgjithshme me shumicë në vitin relevant  $t$

$PSTC_t$  Kostot që barten në vitin relevant  $t$

$NTFR_t$  Të hyrat jotarifore në vitin relevant  $t$

Kostot e lejuara të kapitalit punues (WCLC) përfshijnë edhe kompensimin për ndryshimin mes kostos së lejuar të kapitalit punues WCLC nga SHTE7 dhe kostove të kapitalit punues që kanë dalë si rezultat i raportit sqarues të ZRRE-së. Kostot përfundimtare të kapitalit punues (WCLC) që duhet të mbulohet nga ana e FPEE-s është €2.2 milion.

### 3.5 Faktori i përshtatjes së të hyrave - KREV

Një nga elementet kyçe që prekin MAR-in e Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (por edhe atë të OSSH-së dhe OST/OT-së) është ndryshimi mes Të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) dhe Të Hyrave Aktuale të Rregulluara (ARR). Ky ndryshim mbulohet duke aplikuar formulën e KREV-it të definuar në nenin 5, paragrafi 3.2 dhe Aneksi 1, paragrafi 2.4 i Rregullës për Çmimet e FPEE-së.

Qëllimi i KREV-it është që të sigurojë se brenda secilit vit relevant, Furnizuesi Publik i mbulon ndryshimet mes të hyrave të lejuara dhe aktuale që mund të vjen si rezultat i ndryshimeve në energjinë elektrike të faturuar. Ndryshimet në faturim mund të ndodhin si rezultat i ndryshimit në vëllimin e energjisë elektrike të konsumuar nga viti në vit (ndryshimet mes vëllimit të parashikuar dhe aktual të energjisë elektrike që mund të ndodh si rezultat i ndryshimeve të kushteve klimatike, ndryshimet në shkallën e rritjes ekonomike, etj.). Pavarësisht nga ndryshimi në konsum, Furnizuesi Publik – bazuar në parashikimin e konsumit të energjisë elektrike – është i obliguar që të blejë energji elektrike për të furnizuar kërkesën e planifikuar. Nëse kërkesa është më e ulët se sa parashikimi, atëherë Furnizuesi Publik ngarkohet me kostot përkatëse të cilat janë përtej kontrollit të tij.





Gjatë caktimit final të tarifave me pakicë të energjisë elektrike, ZRRE-ja merr parasysh Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për të mbuluar kostot e arsyeshme të ofrimit të shërbimeve të rregulluara si dhe konsumin e vlerësuar për secilën kategori tarifore përmes së cilave do të mbulohet MAR-i. Raporti i të parës ndaj të dytës qon drejt tarifës përfundimtare me pakicë (€/kWh).

ZRRE-ja ka hetuar mundësinë e llogaritjes së dyfishtë gjatë aplikimit të përshtatjeve të KREV-it dhe ka ardhur në përfundim se formula e KREV-it, siç është dhënë në Rregullën për Çmimet e FPEE, paraqet llogaritjen e dyfishtë të ndryshimeve mes kostove që barten të lejuara dhe aktuale të FPEE-s (kostot e OST/OT dhe OSSH). Kjo më së miri është ilustruar në shembullin në vijim:

Tabela 1 Llogaritjet e dyfishta të KREV-it

		Të lejuar	Aktuale	t+1
Shitjet	GWh	3,000	2,800	3,000
Humbjet		25.0%	25.0%	25.0%
	GWh	1,000	933	1,000
Energjia totale	GWh	4,000	3,733	4,000
DUOS Charge	cent/kWh	1	1	1
Mesatarja e Tarifës me Pakicë	cent/kWh	5	5	5
MAR-i i FPEE	€	15000	14000	16000
Nga e cila kalon nëpër OSSH	€	4000	3733	4267
MAR-i i OSSH	€	4000	3733	4267
KREV-i i FPEE-s	€		1000	
KREVI i OSSH-s	€		267	
MAR i OSSH + FPEE	€	19000	17733	20267
	€		-1267	1267

Shembulli supozon se ZRRE-ja fillimisht ka lejuar MAR-in prej €15,000 nga i cili €4,000 janë kosto që barten OSSH-së. Po ashtu është supozuar se OSSH është në gjendje të arrijë nivelin e humbjeve të lejuara nga ZRRE-ja dhe se shitjet aktuale janë më të ulëta se sa ato të parashikuara për 200 GWh. Në këtë skenar, me çmime të njëjta me pakicë, Furnizuesi publik të merr një ARR prej €14,000 i cili është për €1,000 më i vogël se MAR. KREV-i i OSSH-s (meqë është më i vogël se sa parashikimet për fluksin e energjisë) është po ashtu €267 (ndryshimi mes KREV MAR prej €4,000 dhe KREV ARR prej €3,733). FPEE-ja e bartë përmes MAR-it të OSSH-së përmes KREV-it të vet si kosto që barten. Prandaj, konsumatorët në fakt do të paguajnë €1,267 pavarësisht faktit se ARR-ja e FPEE-s ka qenë vetëm €1,000 më i vogël se MAR.

KREV-i i FPEE-së i cili fillimisht ishte vlerësuar të jetë €15.4 milion (ndryshimi mes MAR-it prej €224.5 milion dhe ARR prej €211.1 milion pas interesit) ishte përshtatur në vlerë më të ulët për vlerën e



KREV-it të OSSH-së dhe është përshtatur me vlerë më të lartë për vlerën e KREV-it të OST/OT për të zgjidhur çështjen e llogaritjes së dyfishtë.

Poashtu duhet të merret parasysh se raporti i kalkulimit të kostos së shitjes me shumicë të energjisë elektrike konstaton se çmimi i energjisë elektrike për shkak të konsumit me të ulet është përshtatur (zvogeluar) për të azhuruar kostot e lejuar me ato aktuale të blerjes së energjisë për vitin 2013 nëvlerë prej 13.3 milion euro. Prandaj duhet të theksohet se përshtatja e KREV në FPEE për të mbuluar shpenzimet e operatorit duke i patur parasysh edhe kostot me tëvogla për blerjen e energjisë është pranuar nga ZRRE vetem pas rishikimit të gjitha kostove tjera të FPEE-së.

Vlera finale e KREV-it për FPEE-në është €12.3 milion.

#### **4 Përmbledhje**

Vlera finale e MAR-it për sektorin për Vitin e Dytë Relevant është €240milion e cila është për €15.4 milion më shumë se sa vlera e lejuar për Vitin e parë Relevant të Periudhës Rregullative.

Kosto e Lejuara me Pakicë (neni 10 i Rregullës për Çmimet e FPEE) janë vlerësuar të jenë €14.2 milion. Këto lejime kanë përfshirë përshtatjet për sigurimin shëndetësor, kostot e rialokuara për Administratës Qendrore dhe ato për licencë. Kostot e lejuara që barten (PSTCt) për pagesë ndaj OSSH-së dhe OST-së janë €81.7 milion. Të hyrat e Lejueshme nga shitjet për humbjet në OST dhe OSSH janë €25.4 milion. Kostot e kapitalit punues janë €2.2 milion. Kostot e Shitjes me Shumicë të Energjisë janë përshtatur për të përfshirë ndryshimin mes marzhës me pakicë të lejuar dhe letrës sqaruese LS prej €0.6 milion. Totali i Kostove nga Shitjet me Shumicë janë €142.3 milion. Borxhet e Këqija të Lejuara janë €12.0 milion me një shumë shtesë prej €0.3 milion për ndryshimin mes vlerave të lejuara dhe letrës sqaruese LS të vitit të kaluar. Lejimet janë përmbledhë në tabelën 6.



**Tabela2 Kostot e Lejuara me Pakicë, Kostot që Barten dhe të Hyrat nga Shitjet për FPEE**

MAR-i i FPEE		SHTE7 I lejuar	SHTE8 I lejuar
<b>Parametrat e Indeksimit</b>			
Faktori i Efikasitetit	%		0.00%
Faktori i Profilizimit			0.00
HICP-Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	%		0.70%
Euribor	%		0.60%
S-factor	%		12.54%
It-Notma e Interesit	%		13.14%
<b>Shpenzimet e Lejuara të Shitjes me Pakicë (RETRt)</b>			
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	12.4	12.4
$DEPCt = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	0.8	0.20
Sigurimi Shëndtësor	€m		0.2
Alokimi I Shpenzimeve të Administratës Qëndrore	€m		1.3
Licenca	€m		0.1
<b>Shpenzimet e Bartshme(PSTCt)</b>			
Taksat e KOSTT-it	€m	15.1	17.8
Taksat e OSSH-së	€m	70.2	63.9
<b>Të ardhurat nga shitja e Humbjeve të OST-së dhe OSSH-së</b>			
Të Hyrat e OST	€m	3.4	3.3
Të Hyrat e OSSH	€m	37.1	23.8
<b>Shpenzimet të Kapitali Punues (WCLCt)</b>			
$WCLC = (1 / 12) * It * (RETRt + WHPCt + PSTCt - NTFRt)$	€m	3.0	2.2
<b>Shpenzimet e Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrik (WHPC)</b>			
WHPC	€m	164.8	142.3
Marzha e Shitjes me pakicë	€m	4.5	
Përshtatja e Marzhës së Shitjes me Pakicë	€m		0.0
<b>Taksa e Licences</b>			
Taksa e Licences	€m	0.0	0.0
<b>Të Hyrat e Parregulluara (NTFRt)</b>			
Të Hyrat e Parregulluara (NTFRt)	€m	-17.9	
<b>Lejimet e Borxheve të Këqija (BDTA)</b>			
BDTA	%	5%	5%
BDTA	€m	12.1	12.0
Përshtatjet/Azhurnimet e Borxheve të Këqija (BDTA)	€m		0.3
<b>KREVt - Faktori Korigjues i të Hyrave</b>			
KREVt I FPEE-së	€m		15.4
KREVt I OSSH-së	€m		3.0
KREVt I KOSTT	€m		-0.2
<b>Përshtatjet Tjera</b>			
Përshtatjet e Shpenzimeve të Pakontrolluara (Sigurimi)	€m		0.2
Përshtatjet e Shpenzimeve të Pakontrolluara (Ri-alokimi I Shpenzimeve të Administratës Qëndrore)	€m		1.3
Taksa e Licences (Importet)	€m		0.0
<b>MAR-i i FPEE-së</b>			
MAR-i i FPEE-së	€m	224.6	240.0